**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**
***Byroja e Kuvendit***

# VENDIM

Nr. 8, datë 17.02.2006

## PËR MARRJEN E MASËS DISIPLINORE NDAJ DEPUTETIT NDRICIM BABASI

Në mbështetje të neneve 11 pika 5, dhe nenit 65 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetares së Kuvendit,

**BYROJA E KUVENDIT**

**VENDOSI:**

I. Pavarësisht nga shkaqet, të përjashtojë deputetin Ndricim Babasi nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

II. Masa disiplinore shoqërohet me sanksion financiar, ndalimin e pagës për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

III. Ngarkohen Shërbimi i Sigurisë dhe Shërbimi i Financës në Kuvend për ekzekutimin e këtij vendimi.

IV. Në rastet e verifikimit të kuorumit, gjatë procedurave të votimit, Sekretariati për Procedurat dhe Votimet, kryen këtë verifikim në përputhje me prezencën fizike të deputetëve në sallë.

V Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare**

**Jozefina Topalli (Çoba)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KUVENDI